



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport /Directorat za Kulturo, Omladinu i
Sport/Departament of Culture, Youth and Sport

Procesverbal i Komisionit vlerësues

Me date 08.09.2023 Komisioni Vleresues ka pranuar 4 aplikacione përmes Zyrës për Shërbime me Qytetarë, ndërsa përmes postës nuk kemi pranuar aplikacione, ne total gjithesej janë 4 aplikacione.

Komisioni i përbërë nga:

- Erson Zymberi – kryesues i komisionit
- Ali Demi – anëtar i komisionit
- Nderim Brestovci – anëtar i komisionit
- Alutrim Dermaku - anëtar i komisionit, ekspert i jashtëm (OJQ)
- Burim Baftiu – anëtar i komisionit, ekspert i jashtëm
- Alban Shahiqi - anëtar rezervë

Fillimisht në ditën e parë të punës Komisioni vleresues i projekteve, ka vendosur rregullat e punës të bazuara në rregulloren MF-NR 04/2017. Gjithashtu Komisioni vleresues ka nënshkruar deklaratën e paanësisë, konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit.

Komisioni i lartëpërmendur për vlerësimin e projekteve është mbështetur në

1. Thirrjen Publike : 13 Nr.84339, Dt.16/08/2023
2. Manualin për implementimin e rregullores MF-NR 04/2017
3. Udhëzuesin e thirrjes: 13 Nr.84346 Dt.16/08/2023
4. Rregullat e punës.

Komisioni ka vendosur që vlerësimin ta zhvilloj përmes dy raundeve:

- Raundi i parë - Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve administrative
- Raundi i dytë - Vlerësim përmbajtësor sipas formës së vlerësimit duke përfshirë vlerësimin teknik në përputhje me kriteret e publikuara në thirrjen publike.

Komisioni ka vendosur që në raundin e parë të vlerësohen paraqitja e dokumentacioneve për secilin aplikues, duke i kategorizuar në:

- **Faza administrative:** Certifikata e regjistrimit të OJQ-së, Certifikata e numrit Fiskal, Vërtetimi/Konfirmimi bankar, Vërtetimi Tatimor, Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit të OJQ-së si dhe formularët e thirrjes publike.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane - Municipality of Gjilan



• Vlerësimi përmbajtësor

Komisioni ka vendosur që për të kaluar në vlerësimin e raundit të dytë, organizata duhet të përmbush fazën e parë të kompletimit të dokumentacionit.

Nga 4 aplikacionet e pranuar, 2 nga to (OJQ Dancing House dhe OJQ Politeia) janë refuzuar në fazën administrative (mungesë e dokumentacionit), ndërsa dy aplikacionet tjera (CCNO dhe OJQ Vullnetarët e Qytetit) janë vlerësuar si më poshtë:

Nr.	Emri Aplikuesit	Titulli i Projektit	Pikët
1	CCNO	Festivali i Teatrit për nxënësit të Shkollave të Mesme në Komunën e Gjilanit	91
2	OJQ Vullnetarët e Qytetit	Festivali i Teatrit për nxënësit të Shkollave të Mesme në Komunën e Gjilanit	81.4
3	OJQ Dancing House	Festivali i Teatrit për nxënësit të Shkollave të Mesme në Komunën e Gjilanit	0
4	OJQ Politeia	Festivali i Teatrit për nxënësit të Shkollave të Mesme në Komunën e Gjilanit	0

Bazuar në vlerësimin përmbajtësor të komisionit vlerësues, CCNO del të jetë fituese e kësaj thirrje publike. Një ndër pikat kryesore të vlerësimit për këtë projekt është bashkë-partneriteti me dy organizatat kulturore me përvojë të dëshmuar.

Bazuar në rregulloren e lartpërmendur, pas shpalljes së rezultateve preliminare, aplikuesit kanë të drejtë ankese prej 5 ditë pune, pas shpalles së rezultateve.

Komisioni vlerësues:

- Erson Zymberi – kryesues i komisionit
- Ali Demi – anëtar i komisionit
- Nderim Brestovci – anëtar i komisionit
- Alutrim Dermaku - anëtar i komisionit, ekspert i jashtëm (OJQ)
- Burim Baftiu – anëtar i komisionit, ekspert i jashtëm

GJILAN, 08/09/2023